PAKR.nr.421/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Kreshnik Radoniqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B. nga fsh. ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga nenin 425 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. K.O., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.55/2019 te datës 30.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, më datë 02.10.2019, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Ferizaj, PKR.nr.55/2019 te datës 30.04.2019, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.55/2019 te datës 30.04.2019, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga nenin 425 par. 1 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim të kushtëzuar, ashtu që të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara KESKO për realizimin e kërkesës pasuroro – juridike është udhëzuar në procedurë kontestimore.

I akuzuari është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 €, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajë shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i te akuzuarit av. K.O., për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i

shqiptohet dënim më i butë, për veprën e kryer penale se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, pa informimin e palëve, ngase, nuk ka bazë ligjore për informim të obligueshëm të palëve.

Prokuroria e Apelit, përmes parashtresës PPA/I.nr.395/2019 i datës 10.09.2019, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Me ankesën e paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit B.B., edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të bazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. K.O., në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, nuk është në proporcion me natyrën dhe as pasojën e veprës penale, ngase, nuk i ka marrë parasysh fare rrethanat lehtësuese e që të njëjtat i potencon në aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka shpallur fajtor të akuzuarin, mirëpo, duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, pendimin e thellë të shprehur nga i akuzuari, pranimin e fajësisë, kërkim falje publike, pastaj, se nuk ka qenë i dënuar asnjëherë më parë, atëherë, është dashur që duke i marrë për bazë dispozitat e parapara për zbutje të dënimit, të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë, sidomos, kur është fjala për dënimin me gjobë, për çka, gjithashtu, përkitazi me këtë nuk është marrë parasysh sidomos fakti se tani më i akuzuari e ka humbur vendin e tij të punës, që do të thotë se dënimi i shqiptuar me gjobë nga gjykata e shkallës së parë, përveç, të akuzuarit e godet edhe familjen e tij, i cili është mbajtës i vetëm i familjes edhe ashtu në gjendje të rëndë ekonomike, prandaj, propozon që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me gjobë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartë përmendura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të

plotë dhe gjithëpërfshirëse jo vetëm që i ka konstatuar rrethanat, por të njëjtat drejtë edhe i ka vlerësuar sikur që parashihet në dispozitat e nenit 73 të KPK-së, ku si rrethana lehtësuese ka marrë pendimin e thellë të akuzuarit për kryerjen e veprës penale pastaj, pranimin e fajësisë dhe atë si rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe faktin se i akuzuari ia ka kompensuar dëmin të dëmtuarës, ndërsa, përkitazi me rrethanat rënduese ka konstatuar se rrethana veçanërisht rënduese nuk ka gjetur, kështu që, rrethanat që ceken në ankesë janë kryesisht rrethana të cilat i ka marrë parasysh edhe gjykata e shkallës së parë, dhe në prezencën e rrethanave në fjalë edhe i ka shqiptuar të akuzuarit dënimin me burgim nën minimum ligjor të dënimit, e pastaj, edhe ia ka kushtëzuar, duke konstatuar kështu se dënimi i shqiptuar me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) €, shumë kjo që nuk është e lartë sidomos kur merret parasysh shuma që ka përvetësuar i akuzuari gjatë kryerjes së veprës penale, pra, bëhet fjalë për një shumë prej 4.994,94 €. Ndërsa, kur është fjala për rrethanat lehtësuese që cekën në ankesë e që nuk i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, të njëjtat nuk mund të konsiderohen si rrethana lehtësuese, sidomos, kur i akuzuari e ka humbur vendin e tij të punës si pasojë e kryerjes së veprës penale, e me këtë kuptohet, familja e tij edhe përkrahjen materiale nga i akuzuari, fakte këto dhe rrethana që nuk mund të konsiderohen si rrethana lehtësuese me ndikim të drejtë për drejtë në zbutjen e mëtutjeshme të dënimit, sidomos kur të akuzuarit gjykata e shkallës së parë, i ka shqiptuar dënim me burgim të kushtëzuar dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 €.

Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, rrethanat e rastit konkret të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e sidomos faktin se në ankesë nuk është cekur rrethanë tjetër që gjykata e shkalles se parë, nuk e ka pasur parasysh në aktgjykimin e ankimuar , kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar me kusht të akuzuarit-duke nënkuptuar edhe kohëzgjatjen e afatit verifikues, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 €, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, ta bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të ndikojë edhe në personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, duke konsideruar kështu se me dënimin e shqiptuar me kusht- pra edhe me kërcënim me dënim, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.421/2019, të dt. 02.10.2019

Procesmbajtëse,	**Anëtarët e kolegjit,**	**Kryetari i kolegjit,**
Leonita Lajçi	**1.Xhevdet Abazi**	**Abdullah Ahmeti**
	2.Kreshnik Radoniqi	